

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **216-26-2603-1-3-6**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me veshmbathje për ngasës të automjeteve zyrtare të MPJD-së RITENDER**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Naim Shuki B.I.
NUI	811294199
Adresa	Wesly Clark Pn
Vendi	PRIZREN
Kodi postar	20000
Numri Telefonit	+383 49841841
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	NAIM SHUKI
Adresa elektronike	infoprinteks@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	03.06.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Furnizim me veshmbathje për ngasës të automjeteve zyrtare të MPJD-së RITENDER
Nr. i Prokurimit 216-26-2603-1-3-6**

**Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – Ministarstvo Inostranih Poslova i
Diaspore- Ministry of Foreign Affairs and Diaspora**

**Titulli: Furnizim me veshmbathje për ngasës të automjeteve zyrtare të MPJD-së
RITENDER**

B05 Njoftim per Kontrat 22.04.2026

Njoftim mbi vendimin e AK.pdf18.05.2026 10:46

B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve04.05.2026 14:01

Kërkesë për rishqyrtim - Rish MPJD Sako 260322.05.2026 18:17

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim

Vendim per Naim Shuki B.I.pdf26.05.2026 13:53

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Kërkesë për rishqyrtim - Rish MPJD Sako 260322.05.2026 18:17

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 1 i LPP-së Qëllimi

Neni 59 i LPP-së Ekzamini vlersimi dhe krahasimi tendereve

Neni 60 i LPP-së Kriteret për dhenjen e kontratës 3/3 F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK

Neni 59 i LPP-së aftësit teknike dhe/ose profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I NDERUAR OSHP,

Mbështetur në nenet përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) në Kosovë, Operator Ekonomik "Naim Shuki" B.I. parashtron këtë **Ankesë** kundër vendimit AK-s për eliminimin e ofertës sonë, si dhe kundër vendimit për shpërblim me kontratë të një Operatori tjetër, i cili sipas gjetjeve tona është i papërgjegjshëm.

Ne konsiderojmë se Komisioni i Vlerësimit ka bërë shkelje drakoniane të **Nenit 7 (Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi)** të LPP-së, duke na eliminuar pa asnjë bazë ligjore dhe pa dëshmi teknike, përkundër faktit që kemi qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

1. Argumentet rreth eliminimit të pabazuar të OE "Naim Shuki" B.I.

Komisioni ka konstatuar se palltoja e dorëzuar si mostër nga ana jonë *"nuk është për përdorim gjithësezonal"*. Ky konstatim është plotësisht subjektiv, arbitrar dhe i pambështetur në asnjë dokumentacion zyrtar.

- -AK nuk ka paraqitur asnjë raport testimi nga ndonjë laborator i certifikuar i tekstit, as ndonjë ekspertizë profesionale që vërteton këtë pretendim.
-
- -Vlerësimi i mostrave duhet të bëhet vetëm mbi bazën e përmbushjes ose mospërmbushjes së specifikimeve teknike të kërkuara në Dosjen e Tenderit (DT) dhe jo mbi preferencat personale apo shijet e anëtarëve të komisionit.
-

2. Shkeljet dhe papërgjegjshmëria e OE të shpërblyer me kontratë

Pas realizimit të të drejtës sonë ligjore për qasje në dokumentacion dhe në mostrat e OE të shpërblyer, kemi vërejtur se Komisioni ka përdorur standarde të dyfishta, duke toleruar mungesa kritike te ky OE:

- **-Pantallonat:** Në mostrën e pantallonave të OE të shpërblyer nuk figuron fare përbërja apo përqindja e materialit, përkundër faktit që në Dosjen e Tenderit është kërkuar në mënyrë taksative që përbërja të jetë **100% Lesh (Super 130'S)**. Mungesa e këtij etiketi apo vërtetimi e bën këtë ofertë automatikisht të papërgjegjshme.
- **-Palltoja (Trench):** Palltoja e dorëzuar nga ky OE është qartazi për sezonin dimëror (e trashë, me lio/mbushje të trashë), çka bie ndesh me vetë konceptin e një palltoje gjithësezonale që AK pretendon se ka kërkuar.

- **-Këpucët:** Në mostrën e këpucëve të OE të shpërblyer nuk ka asnjë tiketë, shenjë apo specifikim që vërteton nëse produkti është material lëkure apo diçka tjetër, ashtu siç kërkohej në DT.

Si dëshmi për të gjitha këto pretendime, kësaj kërkesë ia bashkëngjisim edhe **fotografitë e realizuara gjatë qasjes në mostra**, të cilat vërtetojnë se OE i shpërblyer ka dorëzuar mostra që nuk përkojnë me kriteret e tenderit

KËRKESA JONË:

Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, ku vërtetohet se OE "Naim Shuki" B.I. është eliminuar pa baza teknike e ligjore, ndërsa është favorizuar një OE me mostra të papërgjegjshme dhe me çmim më të lartë se ai i OE 'Naim Shuki' B.I.

1. Të aprovojë si të bazuar këtë Ankesë.
2. Të anulojë Vendimin mbi dhënien e kontratës.
3. OSHP-ja të kryejë vizitë në Autoritetin Kontraktues (AK) për verifikimin dhe vlerësimin e mostrave të dorëzuara.
4. Mostrat të kontrollohen në mënyrë strikte dhe objektive sipas kriterëve të DT-së.
5. OE "Naim Shuki" B.I., si tenderi i përgjegjshëm me çmimin më ekonomik (më të ulët), të shpërblehet me kontratë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme, si në aspektin financiar, fitimet e munguara, si dhe pamundësia për të kompensuar shpenzimet përgatitore të bëra për këtë kontratë. Ndër shpenzimet kryesore theksojmë:

Shpenzimet për përgatitjen e ofertës;

Pagesa për sigurimin;

Kërkimi dhe përgatitja e dokumentacionit për materialet e kërkuara;

Përgatitja e dokumenteve të tjera shoqëruese;

Shpenzimet për ankesa dhe përgatitjen e mostrave.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*